

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Have Haliti, anëtarë me bashkëpunëtoreshen profesionale Arta Dumani, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit J.A., nga Prishtina, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.728/14 të datës 24.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 shtator 2017, mori këtë;

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.728/14 i datës 24.04.2017 VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.728/14, të datës 24.04.2017, i akuzuari J.A. është shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2(dy) viteve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i akuzuari nuk kryen tjetër vepër penale.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50(pesëdhjetë) Euro, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar BpB, nga Prishtina, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, ne afatin ligjor ka ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë dhe të akuzuarit J.A. për veprën penale të kryer t'i shqiptoj dënim më të lartë, e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën e vet PPA/I.nr.369/17, të datës 09.08.2017, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e PTH në Prishtinë, ka propozuar që ankesa e PTH në Prishtinë të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit për veprën penale të kryer t'i shqiptoj dënim më të ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosoves, konform dispozites se nenit 390 par.1 të KPPRK-se, nuk i ka ftuar palët për seancën e kolegjit, ngase në rastin konkret kemi të bëjme me dënim burgu të kushtëzuar dhe prezenca e palëve nuk është e obliguar.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e qështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispoziten e nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vleresimit të pretendimeve të cekura në ankesë gjeti se:

-Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 384 të KPPRK-së dhe konstatoi se i njejtin nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase me ankesë nuk është kontestuar as nga ana e prokurorisë e as nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore të Prokurorisë Themelore lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e përmendura ankimore nga ana e PTH në Prishtinë për shqiptimin e dënimit me të lartë nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit e ka patur parasysh intenzitetin e rrezikimit apo demtimit të vlerësimit të mbrojtur e të cilin rrethane e potencon prokuroria në ankesë, andaj, duke patur parasysh të gjitha këto rrethana, Gjykata e Apelit e Kosovës gjeti se pretendimet e PTH në Prishtinë për

shqiptimin e dënimit më të lartë ndaj të akuzuarit J.A. nuk janë të bazuara, ngase këto rrethana janë vlerësuar ashtu siq parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPRK-së.

Prandaj, duke patur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkretë, mënyrën e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar me burg te kushtezuar të akuzuarit është në harmoni me intenzitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij si dhe të ndikojë edhe në personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lart, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.384/17, Më datë 04.09.2017

Procesmbajtësja

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit,

Arta Dumani

Abdullah Ahmeti

Fillim Skoro

\_\_\_\_\_ Have Haliti